



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIATEPELENË  
KËSHILLI

Nr.184/ 12 .prot.

Tepelenë më, 01.02.2023

**V E N D I M**

Nr.12. datë 31/01/2023

**“Për miratimin paraprak të planeve të mbarështimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullimore, pronë e Bashkisë Tepelenë”**

Këshilli Bashkiak Tepelenë në mbledhjen e datës 31/01/2023 pasi mori në shqyrtim kërkesën e Bashkisë Tepelenë, për miratimin paraprak të planeve të mbarështimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullimore, pronë e Bashkisë Tepelenë, bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” e ndryshuar, neni 27 pika 5 dhe neni 54; ligjin 57/2020 “Për pyjet” neni 11 pika 2b; dhe ligjin nr.9693 datë 19.03.2007 “Për fondin kullimor”, e ndryshuar; në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkisë të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- Komunave/Bashkive”, e ndryshuar; në VKM Nr. 104, datë 5.2.2020 “Për kalimin në pronësi të bashkisë tepelenë të një pasurie dhe për një shtesë në vendimin nr. 843, datë 6.12.2011, të këshillit të ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës”;

**V E N D O S I :**

1. Të pranojë kërkesën e Bashkisë Tepelenë “ Për miratimin paraprak të planeve të mbarështimit pjesor të disa parcelave pyjore dhe kullimore, pronë e Bashkisë Tepelenë ”
2. Të miratojë dokumentin “Plan mbarështimi pjesor për pyjet dhe kullotat pronë e Bashkisë Tepelenë”, për mbarështimin e 3 (tre) ngastrave kullimore të ekonomisë kullimore Kurvelesh, 4 (kater) ngastra kullimore të ekonomisë kullimore Dukaj-Luzat, 2 (dy) ngastra kullimore të ekonomisë kullimore inana, 13 (trembedhete) nen/ngastra pyjore të ekonomisë pyjore Kurvelesh, dhe 11 (njembedhete) ngastra pyjore të ekonomisë pyjore Dukaj-Luzat; i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat pranë Bashkisë Tepelenë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA



Miratuar me 13(trembëdhjetë) vota  
Vota Pro 13(trembëdhjetë)  
Vota Kundër -  
Vota Abstenim -  
Zbardhur me datë 01.02.2023.

KRYETAR

ELVIS SHEHU

